

## DON KISHOTI VEPRJA MË PËRFAQËSUESE E LETËRSISË SPANJOLLE TË PËRKTHYER NË SHQIP

### DON QUIXOTE THE MOST REPRESENTATIVE WORK OF SPANISH LITERATURE TRANSLATED INTO ALBANIAN

ADMIRA NUSHI

Departamenti i Gjuhës Spanjolle, Universiteti i Tiranës, Tiranë, SHQIPËRI

Email: adanushi@hotmail.com

AKTET VI, 3: 329-317, 2012

#### PERMBLEDHJE

Përzgjedhja jonë për këtë studim nuk është e rastit, "Don Kishoti i Mançës" është përfaqësuesi më i mirë i letërsisë spanjolle në shqip. Ai është romani spanjoll më i trajtuar nga kritika letrare shqiptare në kohë. Është ngritur në piedestal, më i ribotuar ndër vite, më i lexuar nga lexuesi ynë. Ky roman dhe personazhet e tij arketip kanë gjetur reflektim në letërsinë shqipe, në jetën politike e sociale të vendit. Përmes këtij studimi trajtojmë një problematikë të veçantë në fushën e komunikimit mes letërsive. Argumenti kryesor qëndron në procesin e receptimit letrar të veprës Don Kishoti i Mançës, të letërsisë spanjolle në ambientin kulturor shqiptar. Ky është një studim empirik, mund të klasifikohet përse i përket metodologjisë në tipin e kërkimeve cilësore e sasiore të ndërthurur, e synon t'i japë përgjigje pyetjeve si dhe pse.

**Fjalë kyce:** përkthim, kritikë letrare, receptim, lexues, bibliografi.

#### SUMMARY

The selection we have made for this study is not casual; Don Quixote is the best representative of the Spanish literature in Albanian. It is the most studied novel by the Albanian literary critique, which has highly praised it. Moreover, it is also the most republished work, the most read by readers and the most present on academic textbooks of all levels of education. The Spanish literature and especially "Quixote" comes in the reception viewpoint this novel and its archetype protagonists have been reflected on the Albanian literature and on its sociopolitical life. The study includes a bibliography. This is an empirical study which can be classified based on the methodology as both a quantitative and qualitative and which aims to respond to the questions how and why

**Key words:** translation, literary criticism, golden century, reception, reader.

---

#### Hyrje

Përzgjedhja jonë për këtë studim nuk është e rastit, Cervantes dhe vepra e tij *Don Kishoti i Mançës*, mbeten të dashur, mjaft të lexuar, të komentuar dhe në proces studimi kritik në Shqipëri. Në vendin tonë, kjo vepër e ka nisur rrugëtimin vetëm 80 vite më parë, në vitin 1932, koha kur Noli e solli në shqip të përkthyer librin e parë. Ky rrugëtim ka marrë emrin: "Udhëtimi i parë i *Kishotit* në Shqipëri". Në vitin 1977, pasi u

përkthye e plotë nga Petro Zheji vepra njih një "udhëtim të dytë" (Uçi, *Drita* 2005).

Fan. S. Noli ka meritë të jashtëzakonshme ndaj lexuesit shqiptar, pasi me romanin *Don Kishoti* organizoi takimin e parë mes tyre dhe Cervantesit. U dha mundësinë shqiptarëve të njihnin një personalitet të letërsisë botërore në kushtet e një zbrazëtie kulturore e në kushtet e një paradoksi politik dhe shqipëroi një kryevepër të përkthyer në të gjitha gjuhët e botës, duke i

ofruar shqipes një kontribut të jashtëzakonshëm. Dëshmoi sa e begatë është shqipja, madje dha një model të përsosur shqipërimi. Noli me këtë përkthim pasuroi intelektualisht lexuesin shqiptar. Prezantoi një hero idealist.

### 1. Kritika shqiptare mbi veprën e Cervantes - it të përkthyer në shqip

Kritika shqiptare në vite, i ka kushtuar kujdes të veçantë veprës *Don Kishoti i Mançës* të Cervantes-it. Janë shkruar libra dhe artikuj të shumtë kritikë, ku në fokus janë vënë autori, vepra në vetvete, personazhet veç e veç, por dhe përballë, filozofia e veprës, gjithëkohshmëria e saj, gjithëpërfshirja, larmia tematike, ndërthurja e reales me idealen e çmendurisë, me urtësinë, evoluimin, tjetërsimin, groteskun apo burleskun, parodinë. Vlerësimi estetik shqiptar sheh një autor të shquar që shkroi një vepër të pavdekshme. Një vepër që thërret interesin artistik të të gjitha moshave, të rinj e pleq. Një temë e madhe, origjinale, që përfshin brenda vetes tragjedinë dhe komedinë e kohës, në Spanjë.

Kritika shqiptare e dy shekujve të fundit (XX, XXI) është rrekur ta kontekstualizojë veprën në realitetin shqiptar, e sjell në koherencë, gjenë kuptim dhe i jep përgjigje realiteteve shqiptare përmes Kishotit.

Nuk qe rastësi që Noli zgjodhi të përkthejë *Don Kishotin e Mançës*, nxitje të fuqishme i dha momenti historik, kushtet sociale dhe politike të Shqipërisë, feudalizmi i errët shqiptar. Noli, siç rrëfen në parathënien e librit shqiptarëve u dha në duar një vepër monumentale, të pavdekshme të kulturës botërore, sepse shikonte ngjashmëri të çuditshme mes Spanjës mesjetare që vuante nga Filipi III e inkuizicioni fetar dhe Shqipërisë që shtypej e merrej nëpër këmbë nga bejlorçina feudale dhe kleri, nga fajdexhinjtë e bashibozukët e Zogut, që i rrinin me këlliç mbi kokë. “*Në Shqipëri kjo vepër do të kuptohet më mirë se kudo gjatë. Se atje tipat e bejlorçinës dhe të laros i gjejmë në çdo hap*” (Noli 1975: 5). Në mendimin tonë Noli është jo vetëm përkthyesi por dhe kritiku i parë përmes Introdiktës së tij.

Gazeta “Illyria” e datës 8 shkurt 1936, në një artikull të Ali Kurit, me pseudonim Thoma

Sorrow, ndër të tjera sjell shqetësimin se s’pat jehonë ardhja e kryeveprës në shqip: “*As një fjalë nuk u bë, /.../ u prit me indiferencën tonë të zakonshme ardhja e kësaj kryevepre Castigliane në gjuhën tonë*”. Intelektualët e kohës shohin tek ky përkthim shenjat e emancipimit e të qytetërimit si gjuhë e si komb, duket se për ta është më e rëndësishme që bota të marrë vesh, shqiptarët të marrin vesh se Kishoti është “*në mes tonë*”, personazhi që tronditi botën mesjetare është “*në mes tonë*”, se sa vlerësimi i përkthimit në vetvete, i Nolit si përkthyes.

Në vitet në vijim para ardhjes së demokracisë publiku, krijuesit e kritika ishin mësuar ta vlerësonin veprën sipas optikës së Nolit, ta projektonin veprën në bashkohësi, përveçse iu përmbajtën këtij kriteri, e pasuruan me mesazhe e kuptime të reja të padëguara më parë.

Plasari e P. Jorgoni u përpoqën të zgjerimin kuadrin e domethënies estetike të veprës. Duke vlerësuar interpretimin e Nolit tentuan të vënë në dukje se ky interpretim ka mungesë analize dhe u përpoqën të tërheqin vëmendjen e lexuesit në pikëpamjet e shumta që kritika në mbarë botën, në kohë të ndryshme, ka dhënë mbi romanin. D. Shaplo sheh se problematika e ëndrrës për të vijuar fisnikërinë e rrënuar, për drejtësi në botë, për të mbrojtur ata që vuajnë, për t’u ndeshur me viganët keqdashës /.../ nuk mbeti vetëm spanjolle, por mbarëbotërore (Shaplo 2004: 14).

### 2. Tri kohët e perceptimit të *Don Kishotit*

Nëse do përpiqeshim të ndërtonim një hartë kohore, një periodizim, i cili do tregonte në kohë *Kishotin* në Shqipëri, do ta ndërtonim në tri kohë. Filledën *Kishoti* e ka në vitin 1932, kur u përkthye së pari nga Noli, deri në vitin 1945, më pas vijon me të dytën 1945 deri 1990; dhe koha e fundit 1991 deri sot.

Kishoti ka jetuar këto tri kohë në Shqipëri dhe i janë veshur në çdo kohë karakteristikat e kohës që ideologjikisht vendi ynë jetoi, pa i zbehur lavdinë e pa e përdhosur *Kishotin* e Cervantes-it. Lehtësisht kuptohet që *Kishoti* ka njohur të njëjtat data që historia e Shqipërisë njeh. *Kishoti*

duket i kushtëzuar nga vijimi ynë politik, shoqëror, historik madje dhe kulturor.

Në periudhën e parë kritika studimore letrare ndaj veprës ka një performancë naive deri diku, në periudhën e dytë duket e ngurtë, e kufizuar, në periudhën e tretë shfaqet shpërthyes, e papërmbajtur, e thellë, plot fantazi. *Kishoti* është i njëjti. Pra mendimi estetik mbi romanin ka ndryshuar, evoluar.

Duam të theksojmë se dhe në Shqipëri vihet re një fenomen që kudo në botë gjendet: secili drejtim artistik e ideologjik mundohet ta interpretojë sipas pikëpamjeve të veta, t'ia përshtasë platformës së vet filozofike, t'u japë personazheve të veprave dhe shkrimtarit një shpjegim të vetin.

Alfred Uçi akademik, është personaliteti shqiptar që me shumë përkushtim prej disa dhjetra vitesh studion Cervantesin e *Kishotin*. *"Romani Don Kishoti ishte shëmbull i shkëlqyer se si mund të çlirohej letërsia artistike nga idealizimi i heronjve dhe nga koncepti metafizik që nuk i pranonte përzierjet e dinamizmin estetik, duke i ndarë prerazi, në mënyrë absolute botën e Krishtit nga bota e Satanit. Heronjtë e Servantesit ishin të një tipi tjetër: të ndërlikuar, kompleksë e kontradiktorë"* (Uçi, Drita 2005).

Isamil Kadare: *"Karakterin ynë (e ka fjalën për shqiptarët) është donkishotesk, në kuptimin më të mirë të fjalës, sepse unë si shkrimtar vlerësoj tek Don Kishoti jo vetëm marrëzinë, por dhe fantazmagorinë, çmenduri (delir) e bukur që ka të bëjë me lirinë"* (Kadare 2009). I. Syla, sjell një analizë psikologjike të personazhit të Kishotit. Sipas tij, Cervantesi në disa qindra faqe libër heroin e vet e vë në provë të rëndë. Shfaqet mendimtar racional, i kthjellët, filozof e orator i përkryer (Syla 2006).

Për të gjithë ne është e qartë se udhëtimi i brendshëm ka të bëjë me thellësinë e mendimit, me meditimin, me inteligjencën, me analiza të thella e konkluzione, me filozofi. Mendojmë se kurrë më parë, kritika shqiptare nuk e kishte shpërfaqur me këtë përmasë urtësinë e marroket, sa pas viteve nëntëdhjetë.

Forca e Kishotit qëndron tek besimi i plotë që ka në fundin triumfues, rëniet dhe disfatat nuk i

humbin shpresën, por përkundrazi ai di të jetë i lumtur. Kjo është karakteristikë e njeriut, e njerëzimit dhe e Kishotit. Nëse Kishoti do dinte fundin që në fillim, me siguri do ta shpallte vetë me gojën e tij marrëzinë e vet. Asnjë Don Kishot që gjendet brenda nesh nuk e sheh dot fundin e tij.

Dy vepra të plota kritike dhe studimore kushtuar Cervantesit e *Kishotit* në Shqipëri janë shkruar nga Alfred Uçi (2005, 2010) dhe Ali Aliu (1995).

A Uçi në përsosje të përkufizimit të tij mbi *"donkishotizmin"* thotë: *"donkishotizmi është mpleksje e mënçurisë me urtësinë e me marrëzinë"*. Çdo njeri normal është gabuar në llogaritë e veta dhe pasi ka fituar eksperiencë jetësore nuk e ka garancinë se nuk do të përsërisë veprime *"donkishoteske"* qofshin qesharake, fatkeqe a të urta. Ky ishte një zbulim i madh estetik në letërsinë e kohës, pasi letërsia e më parshme kishte parimin estetik të idealizimit të heroit me atribute të kulluara morale o fizike. Shkrimtari e studiuesi letrar Ali Aliu, botoi në gjuhën maqedonase e më pas në shqip, një libër me autorët më në zë të letërsisë shqiptare të dy shekujve të fundit, titulluar *Don Kishoti shqiptar. Një histori ndryshe e letërsisë shqipe"*.

Ky libër me vlerat e një antologjie të letërsisë shqipe, përfshin 13 autorë nga Shqipëria, Kosova, Maqedonia e *"ka për qëllim të ndriçojë në mënyrë kritike dhe reale, disa autorë të dalluar shqiptarë, ndër më të afirmuarit në botë"*. Këta shkrimtarë *"në periudha të gjëra e të gjata kohore do t'ia dorëzojnë stafetën donkishoteske njëri – tjetrit, duke besuar se jetën e tyre e kishin lidhur me kauzën e madhe: mbrojtjen e identitetit gjuhësor të popullit të tyre"* (Aliu 2010: 14, 15, 19, 102, 107).

Ali Aliu i quan heronj të gjithë këta shkrimtarë si: Kadare, Agolli, Poradeci, De Rada, Frashëri, Azem Shkreli, Ali Podrimja, Noli, Konica, Arapi, Luan Starova, Spahiu, Kim Mehmeti. Ata janë ana gjeniale e kombit shqiptar si Kishoti dhe Sanço janë ana gjeniale e shpirtit të Cervantes. Ai zgjodhi të shohë jetën dhe veprën e këtyre autorëve shqiptarë tek të cilët ekziston *"gjeniu donkishotesk"*. Në veprën e tij, na tërheq drejt analizave ekzistenciale, si: njeriu nuk jeton dot pa

iluzionin e Kishotit për të ndrequr botën. Është ky iluzion që vë në lëvizje shpirtin dhe mendjen. Bota, sipas tij, është aq e pandreqshme, ashtu siç është i përjetshëm iluzioni për ta ndrequr atë. Ëndërrimi e iluzioni janë vidha kyç të jetës së njeriut, kjo e bën Kishotin një si ne, aspak të ndryshëm. Bota nuk jeton dot jashtë këtij ëndërrimi, çdonjëri nga ne ka në vetvete një mendje të kthjellët dhe një Kishot ëndërrimtar (Aliu 2010: 14, 15, 19, 102, 107).

### 3. Prezenca dhe reflektimi i letërsisë spanjolle në letërsinë shqipe përmes *Don Kishotit*

Prezenca dhe influenca e letërsisë spanjolle në letërsinë shqipe përmes *Don Kishotit* sipas kritikës letrare shqiptare, është e dukshme. Duam të sjellim si shembull groteskun (apo burleskun) e Cervantesit, aq i dashur nga shkrimtarët shqiptarë para viteve 90. Me mantelin e groteskut u veshën disa të vërteta të vështira për t'u shprehur a denoncuar në ato vite: Kadare, Nonda Bulka, Agolli, Buxheli, Kallamata, Kosta, Niko Nikolla, Bubani.

A. Uçi, ndërsa studion veprën e Cervantesit vendos paralele mes saj dhe *Shkëlqimi e rënia e shokut Zylo* të Agollit. Në analizën e tij ai gjen lidhje të ngushtë mes dy romaneve përsa i përket veprimit mbi publikun artdashës shqiptar. *“Shkëlqimi e rënia e shokut Zylo çeli ca shtigje, që të kuptoheshin ca të vërteta për jetën tonë, njohjen e të cilave e ndihmonte jo më pak dhe Don Kishoti”* (Uçi 1995).

Studiuesi ngul këmbë se në vitet 70, të dy romanet plotësonin njëri – tjetrin. Gjithmonë brenda kulturës së kohës, zbulonin një “sekret” – të vërtetën e kohës e të regjimit, i cili subjektivisht ishte i fortë, por objektivisht ishte i rënduar.

Don Kishoti, doli nga statusi i personazhit të Cervantesit. Tanimë ai u bë personazh novelash, romanesh, vjershash për fëmijë e të rritur të shkrimtarëve shqiptarë. Vlejnë të përmenden këta tituj: *Aventurat e Don Kishotit në Shqipëri* (Saro 2003); *Nipi i Don Kishotit në Shqipëri* (Karadaku 2005); *Don Kishoti në disko* (Myftari 2008); *Sokrati dhe Don Kishoti* (Alimani 2009).

*Kishoti* është një hero i madh tashmë, është shndërruar i pamëshirshëm, është shkëputur nga

shkrimtari, jeton më vete. Ka shkuar koha kur Kishoti ishte vetëm një figurë komike. A nuk e bën të madh Kishotin, fakti që është i njohur ende pa ia lexuar historinë? Madhështia e një figure të tillë matet edhe me faktin se sa i drejtohen atij brezat e rinj. Ky mbetet argument i hapur.

Kadare duket mjaft i kthjellët ndërsa e vështron personazhin e Kishotit, madje duket se ka keqardhje ndërsa sheh t'i përdoret emri nga politikanët, pasi *“Don Kishoti del i humbur në të gjitha rastet, sepse në të gjitha rastet politikanët që ia përmendin emrin, janë në nivelin e tij dhe nuk kanë një grimë nga fisnikëria e tij”* (Kadare 2001).

Në Shqipëri, sot, figura e Kishotit, përdoret shpesh mes partive politike. Nuk ka forcë politike që të mos e ketë akuzuar kundërshtarin Don Kishot. Dhe historia vazhdon sot.

Jorgo Bllaci shkruante më 1993: *“Po të më thonin se në ç’pozitë do dëshiroja të isha në atë të Sanços dhe apo Kishotit, unë do të zgjidhja pa ngurim këtë të fundit”* (Bllaci 1993).

Ndërsa i mirënjohuri Kim Mehmeti ndërton një artikull të mrekullueshëm vlerësues për Ali Aliun: *“Ali Aliu, Don Kishoti i shqiptarëve të Maqedonisë”* (Mehmeti 2007). Dukshëm njerëzit e letrave e të kulturës nuk konfundohen si politikanët, Kishoti përbën krenari për ta. *“Nuk mund të lejohet që Don Kishoti të përdoret në diskutimet politike. Historia e vërtetë e botës, ajo që i intereson letërsisë dhe së cilës i përket Don Kishoti, është siç thamë më lart, historia e brëndshme e saj. Kalimi nga një botë tek tjetra, me fjalë të tjera, dalja në klimën e egër të botës ku ne jetojmë, siç është rasti i Don Kishotit, mund të ketë rrjedhoja dramatike.”* (Kadare 2005).

### 4. Përse *Don Kishoti*, është vepra më e rëndësishme e letërsisë spanjolle në shqip

Për gjatë këtij studimi vëmë re se për asnjë vepër të përkthyer nga spanjishtja apo autor spanjoll nuk janë ndërtuar kaq shumë artikuj kritikë sa për *Kishotin* e Cervantesit. Asnjë vepër e përkthyer nga spanjishtja në shqip nuk është ribotuar në vite e përshtatur ndaj grup moshave kaq shumë

sa *Kishoti*. Vëmëndja ndaj tyre është shumë e madhe, madje absolute, arsyen e gjen të komentuar me fjalë të ndryshme, por ideja është një, autor i madh, vepër me vlera artistike të jashtëzakonshme, bartëse e një filozofie gjithmonë bashkëkohore, universale. Penat më të mëdha të Shqipërisë në këta dy shekuj shënuan mendimin, emocionin e studimet e tyre mbi *Kishotin* e Cervantesit, si Kadare, Agolli, Perikli Jorgoni, Nonda Bulka, Uçi, Kostallari, Aliu.

Ndër 137 artikuj kritikë të identifikuar nga viti 1932 deri sot, 52 janë shkruar për Cervantesin dhe *Kishotin*.

Përse *Don Kishoti i Mançës*, është romani përfaqësues i letërsisë spanjolle në gjuhën shqipe?

- është romani më i ribotuar nga letërsia spanjolle.
- është romani më i trajtuar, më i studiuar.
- është e vetmja vepër e plotë nga letërsia spanjolle që studiohet, në ciklet shkollore.

Letërsia e Shekullit të Artë spanjoll e në veçanti Cervantesi influencuan fuqishëm shkrimtarin e përkthyesin Fan Noli. Por Nolin e parapriu Ndoc Vasija nga Shkodra, i cili në vitin 1928 realizoi përkthimin e disa kapitujve të *Don Kishotit të Mançës*. Gjithsej 145 faqe, në një përkthim të "lirë", sipas përkthyesit, Shtëpia Botuese "Shtypshkronja e së Papëlyemes" (Cervantes 1928).

Noli, në vitin 1932 filloi publikimin e përkthimit e librit të parë, të cilin e realizoi në pesë pjesë. Pjesa e fundit u botua në vitin 1933 dhe çdo pjesë ka nga 96 në 112 faqe. Titulluar: *Sojliu mëndje-mprehtë Don Kishoti i Mançës*. Shtëpia Botuese "Mass", Boston.

Për herë të parë në Shqipëri ky libër u botua në vitin 1944, por vepra nuk erdhi e plotë. Në kapakun e librit u shkrua: *Provonjësi i krisur*, nga vepra *Don Kishoti i Mançës*. Shtëpia Botuese "Argus", Tiranë 1944.

Në vitin 1956, Cervantes vjen në Shqipëri, me titull *Sojliu mëndje -mprehtë Don Kishoti i Mançës*. Libri i parë u botua i plotë. Vepra u ribotua më pas në vitet 1961, 1977, 2000, 2002, 2003, 2005, 2008, 2009, 2010, gjithmonë në Tiranë nga Shtëpia Botuese të ndryshme.

Në vitin 1977, pas përkthimit që Petro Zheji i bëri librit të dytë të Don Kishotit me të njëjtin titull *Sojliu mëndje mprehtë Don Kishoti i Mançës*, nga Shtëpinë Botuese "Naim Frashëri", në Tiranë, vepra botohet e plotë, për herë të parë, me dy libra (Cervantes 1977). Merr vlerën e një të rëndësishme dokumentare informacioni i nxjerrë në një shkrim të Andrea Varfit, ku thuhet se u botuan të dy vëllimet së bashku në një tirazhi me 20 mijë kopje (Varfi 1987).

### Bibliografi

- ALIMANI F. (2009), *Sokrati dhe Don Kishoti*, Roman, Onufri, Tiranë.
- ALIU A. (2010), *Don Kishoti shqiptar, Një histori ndryshe e letërsisë shqipe*. Toena, Tiranë.
- ALIU A. (1995), *Don Kishoti në Shqipëri dhe studime letrare*, Flaka e vëllazërimit, Shkup.
- BLLACI J. (1993), Midis Sanços dhe Kishotit do të zgjidhja pa ngurim këtë të fundit: *Gazeta Drita* (9 maj), Tiranë.
- CERVANTES M (1928), *Aventurat e Don Kishotit të Servantes*. Shtypshkronja e së Papëlyemes, Shkodër.
- CERVANTES (1977), *Don Kishoti i Mançës*, Naim Frashëri, Tiranë.
- KADARE I. (2005), *Don Kishoti në Ballkan: Shekulli, 2 mars*, Tiranë.
- KADARE, I. (2001), *Don Kishoti në politikën e shekullit të XX*. Fjala e shkrimtarit në Bibliotekën Kombëtare të Madritit 1994, *Unaza me kthetra*, Tiranë.
- KADARE, I. (2009), *Çmuj lumturinë që mbart takimi me lirinë*. Intervistë për Jose Manuel Fejardo, 25 qershor.
- KARADAKU, Xh. (2005), *Nipi i Don Kishotit në Shqipëri*. Vjersha për fëmijë, Shtëpia botuese Ura, Prishtinë.
- MEHMETI K. (2007), Ali Aliu, Don Kishoti i shqiptarëve të Maqedonisë: *Gazeta Shqiptare*, 28 janar, Tiranë.
- MYFTARI E. (2008), *Don Kishoti në disko*. Roman. Shtëpia botuese Toena, Tiranë.
- NOLI F. (1975), *Don Kishoti i Mançës*, Introdakta. Naim Frashëri, Tiranë.

SARO V. (2003), *Aventurat e Don Kishotir në Shqipëri*, Novelë gazmore për fëmijë, Art Studio Design, Tiranë.

SHAPLLO, Dalan (2004), Kalorësi i vrerosur nëpër botë: *Gazeta Drita*, 11 Korrik, Tiranë.

SYLA I. (2006), Aventurë e re me sejmenë të vjetër: *Albania*, 5 shkurt, Tiranë.

UÇI, A (2005), Me rastin e 400 vjetorit të botimit të "Don Kishoti i Mançës" nga Miguel Servantes: *Drita*, 18 shtator, Tiranë.

UÇI, A. (2010), *Filozofia e Donkishotizmit*. Akademia e Shkencave, Tiranë.

UÇI, A. (1995), Shtegtimi i Don Kishotit në Shqipëri: *Zëri i popullit*, 14 janar, Tiranë.

UÇI, A. (2005), *Shtegtimi i Don Kishotit në Shqipëri*. Akademia e Shkencave, Tiranë.

VARFI A. (1987), Servantesi: *Ylli*, 11 nëntor, Tiranë